



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E LARTË  
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

**Nr. 179 i Vendimit**

**V E N D I M**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

**Sokol SADUSHI     - Kryesues**  
**Ervin PUPE         - Anëtar**  
**Ilir PANDA          - Anëtar**

Në datën 08.06.2020, mori në shqyrtim në dhomën e këshillimit çështjen administrative, që u përket palëve:

**KËRKUES:**           Enver Ruka

**OBJEKTI:**           Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr.1210, datë 27.03.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.  
Pezullimin e veprimeve përmbarimore sipas lajmërimit për ekzekutim vullnetar me nr.15958 datë 23.12.2019, komunikuar në datën 21.01.2020.

**BAZA LIGJORE:**    Neni 479 të Kodit të Procedurës Civile

**Në çështjen me :**

**PADITËS:**           Prefekti i Qarkut Tiranë

**PADITUR:**          Enver Ruka

**KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË**

Pasi dëgjoji relacionin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe diskutoi çështjen në tërësi në dhomën e këshillimit,

**VËREN**

**I- RRETHANAT E ÇËSHTJES**

21- Nga aktet e administruara në praktikën gjyqësore, rezulton se pala e paditur Enver Ruka është përfitues i një sipërfaqe toke sipas AMTP viti 1999 me sipërfaqe 7000 m2,

AMTP viti 2000 me sipërfaqe 3000 m2 dhe AMTP viti 2000 me sipërfaqe 27.000 m2, të dala në emër të familjes bujqësore të përfaqësuar nga Hasan Haxhi Ruka.

2- Nga ana e palës paditëse Prefekti i Qarkut Tiranë, është iniciuar procedura administrative e verifikimit të titujve të pronësisë dhe në përfundim me vendimin nr.291 datë 228.10.2016 Komisioni Vendor i Verifikimit të Titujve të Pronësisë ka shfuqizuar plotësisht AMTP e sipërcituara dhe detyrimin e palës është paditur të kthejë shumën prej 16.576.000 lekë.

3- Për sa më sipër, paditësi duke pretenduar se pala e paditur ka vepruar në kundërshtim me ligjin, i është drejtuar gjykatës me padinë objekt gjykimi.

4- **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë**, me vendimin nr.1210, datë 27.03.2017 ka vendosur:

Pranimin e padisë së palës paditëse Prefekti i Qarkut Tiranë.

Shfuqizimin e plotë të Aktit të Marrjes së Tokës Bujqësore në Pronësi, pa numër akti, viti 2000 me sipërfaqe totale 27.000 m2, Aktit të Marrjes së Tokës Bujqësore në Pronësi, pa numër akti, viti 2000 me sipërfaqe totale 3.000 m2 dhe Aktit të Marrjes së Tokës Bujqësore në Pronësi, pa numër akti, viti 1999 me sipërfaqe totale 7.000 m2, lëshuar në emër të familjes bujqësore me përfaqësues shtetasin Hasan Haxhi Ruka, të lëshuar nga Komisioni i Ndarjes së Tokës në fshatin Mëzes, Njësia Administrative Kashar.

Detyrimin e familjes bujqësore të paguajë vlerën e pasurive të përfshira në Aktet e Marrjes së Tokës Bujqësore në Pronësi të mësipërme dhe të shitura me sipërfaqe totale 37.000 m2, në shumën 16.576.000 (gjashtëmbëdhjetë milion e pesëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë) lekë.

5- **Gjykata Administrative e Apelit Tiranë**, me vendimin nr.2497, datë 25.09.2019 ka vendosur:

Lënien në fuqi të vendimit nr.1210, datë 27.03.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

6- Më datë **27.01.2020** Enver Ruka, ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në thelb parashtrohet se vijon:

- *Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit kemi ushtruar rekurs, mbasi ky vendim është marrë në kundërshtim me ligjet, sepse vlera e tokës që duhet të kthejmë palës së paditur nuk është tokë e përfituar sipas ligjit për tokën pavarësisht se na janë dhënë AMTP .*
- *Këtë tokë e kemi përfituar në bazë të vendimit nr.115 datë 14.10.1997 të ish KKKP Bashkia Tiranë si ish pronar i kësaj toke, duke na njohur edhe të drejtën për parablerjen e espek të ngritura mbi tokën tonë.*
- *Kjo e drejtë e jona është sanksionuar me vendimin unifikues nr.24 datë 13.03.2002 të Gjykatës së Lartë, ku thuhet shprehimisht se ligji për kthimin dhe kompensimin e pronave ish pronarëve nuk është mënyrë e re e fitimit të pronësisë po korrigjim i padrejtësisë së bërë.*
- *Ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda, pasi duhet të riblejme edhe njëherë tokën tonë.*

## **II- VLERËSIMI I KOLEGJIT ADMINISTRATIV TË GJYKATËS SË LARTË**

7- Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aspektit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

8- Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i aspekteve dhe eminent për shkakimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

9- Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose

b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin e vendimit.”.

10- Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet aspektet rish dhe qartësisht se:

- ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të pariparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;
- (nuk) cenohet rëndë interesi publik.

11- Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të aspektetve të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

12- Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të

formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat espektive të saj. Në këtë kuptim argumentat e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

13- Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashkuar nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjësisë personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

14- Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në funksion të zgjidhjes së çështjes konkrete, vlerëson se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë e paraqitur nga pala e paditur, Enver Ruka, është e pabazuar në ligj dhe si e tillë nuk duhet të pranohet.

15- Ky Kolegj vëren se, në zbatim të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, bashkëlidhur kërkesës për pezullim të palës kërkuese Enver Ruka, gjendet edhe kopja e rekursit të ushtruar nga kjo palë kundër vendimit gjyqësor që kërkohet të pezullohet ekzekutimit.

16- Gjithashtu, ky Kolegj vëren se palët e tjera pjesëmarrëse në gjykimin e çështjes ku është dhënë vendimi gjyqësor që kërkohet të pezullohet, janë njoftuar rregullisht për kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese Enver Ruka, të cilat nuk kanë parashtruar argumente lidhur me bazueshmërinë në ligj të kërkesës për pezullim dhe për qëndrimin e tyre.

17- Nga shqyrtimi i shkaqeve konkrete për të cilat pala kërkuese Enver Ruka kërkon pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, Kolegji Administrativ vlerëson se, kjo Kërkesë, në tërësinë e saj, motivohet me shkaqe që kanë të bëjnë vetëm me drejtësinë, bazueshmërinë në prova dhe në ligj, të vendimeve të dhëna nga gjykata administrative e shkallës së parë dhe ajo e Apelit në zgjidhjen e çështjes, të cilat ky Kolegj i vlerëson në kohën kur shqyrton në dhomë këshillimi shkaqet e rekursit ndaj vendimit të gjykatës administrative të apelit.

18- Për sa i përket motivit të fundit dhe të vetëm, që formalisht përfshihet në rastin e shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, Kolegji Administrativ vëren se pala kërkuese Enver Ruka nuk ka paraqitur asnjë provë dhe nuk ka arsyetuar lidhur me ndonjë rrethanë konkrete për ta vlerësuar nëse jemi ose jo përpara rastit kur Gjykata e Lartë mund të konkludojë se nga ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit gjyqësor do të vinin pasoja të rënda financiare për palën kërkuese Enver Ruka.

19- Kolegji Administrativ vlerëson të evidentojë se, duke mbajtur parasysh edhe natyrën e mosmarrëveshjes mes palëve, pozitën e palës kreditore dhe asaj debitore, si edhe natyrën dhe vlerën e detyrimeve që kërkohet të ekzekutohen në çështjen konkrete në shqyrtim, në interpretim dhe zbatim të drejtë të ligjit procedural, mbetet thjesht një kërkim

dhe pretendim hipotetik dhe, si i tillë, i pambështetur në ligj, vetëm parashtrimi formal i pretendimit (shkakut) se ekzekutimi mund të sjellë pasoja të rënda financiare, si një shkak që e përcakton vetë neni 479 pika 1 shkronja “a” e Kodit të Procedurës Civile, pa parashtruar njëkohësisht edhe argumenta dhe shpjegime konkrete lidhur me rrethanat që tregojnë mundësinë e ardhjes së tyre.

20- Ky Kolegj, vlerëson të theksojë qëndrimin e Gjykatës së Lartë, e cila çon automatikisht në rrëzimin e kërkesës si të pambështetur në ligj, se kërkesa për pezullimin e ekzekutimit, nuk është shoqëruar me vendosjen e garancisë në zbatim të nenit 479 pika 1 gërma “b” të K.Pr.Civile.

21- Për sa më sipër, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se nuk ka vend për të pranuar kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese Enver Ruka, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.1210, datë 27.03.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

### **PËR KËTO ARSYE**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 1 pika 2 e ligjit nr.49/2012 “*Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative*” dhe nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile;

### **V E N D O S I**

Mospranimin e kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.1210, datë 27.03.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të paraqitur nga Enver Ruka.

**Tiranë, më datë 08.06.2020**

**ANËTAR**  
**Ilir PANDA**

**ANËTAR**  
**Ervin PUPE**

**KRYESUES**  
**Sokol SADUSHI**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E LARTË  
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

**Nr. 19/280 i Vendimit**

**V E N D I M**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

**Sokol SADUSHI - Kryesues**  
**Ervin PUPE - Anëtar**  
**Ilir PANDA - Anëtar**

Në datën 08.06.2020, mori në shqyrtim në dhomën e këshillimit çështjen administrative, që u përket palëve:

**KËRKUES:** Alfred Bej

**OBJEKTI:** Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr.560, datë 26.02.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë dhe vendimin nr.5706, datë 11.11.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

**BAZA LIGJORE:** Neni 479 të Kodit të Procedurës Civile

**Në çështjen me :**

**PADITËS:** Autoriteti i Mediave Audiovizive

**PADITUR:** Alfred Bej

**KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË**

Pasi dëgjoji relacionin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe diskutoi çështjen në tërësi në dhomën e këshillimit,

**VËREN**

**I- RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1- Nga aktet e administruara në praktikën gjyqësore, rezulton se pala e paditur Alfred Bej, me ka punuar deri në datë 26.10.2010, në detyrën e Drejtorit të Kabinetit të Kryetarit të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit (sot Autoriteti i Mediave Audiovizive).

2- Nga ana e palës paditëse Autoriteti i Mediave Audiovizive, me urdhërin nr.282 datë 26.10.2010, është liruar nga detyra pala e paditur Alfred Bej dhe çështja është bërë konflikt gjyqësor pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë e cila me vendimin nr.6539 datë 21.07.2011 ka pranuar padinë dhe i ka njohur dëmshpërblimet përkatëse. Ky vendim mbas ankimit është gjykuar në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila me vendimin nr.299 datë 16.02.2012 ka lënë në fuqi vendimin e shkallës së parë.

3- Në vijim rezulton se ndaj vendimeve të sipërcituara është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë, e cila ka shqyrtuar çështjen dhe me vendimin nr.521 datë 16.10.2014 ka ndryshuar të dy vendimet dhe ka rrëzuar padinë.

4- Në këto pala paditëse Autoriteti i Mediave Audiovizive ka vijuar ekzekutimin e vendimit dhe kthimin e shumave të marra mbi bazën e dy vendimeve të gjykatave të faktit, për sa kohë këto vendim u prishën nga Gjykata e Lartë.

5- Për sa më sipër, paditësi duke pretenduar se pala e paditur ka vepruar në kundërshtim me ligjin, i është drejtuar gjykatës me padinë objekt gjykimi.

**6- Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë**, me vendimin nr.5706, datë 11.11.2015 ka vendosur:

Pranimin e kërkesë padisë.

Detyrimin e palës së paditur Alfred Bej, t'i kthejë paditësit Autoriteti i Mediave Audiovizive shumën prej 1.995.656 lekë, si pasojë e begatimit pa shkak të tij.

**7- Gjykata Administrative e Apelit Tiranë**, me vendimin nr.560, datë 26.02.2019 ka vendosur:

Lënien në fuqi të vendimit nr.5706, datë 11.11.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

8- Më datë **10.05.2019** Alfred Bej, ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në thelb parashtrohet sa vijon:

- *Ky vendim është marrë në zbatim gabuar ligjit procedural, pasi begatimi pashkak i pretenduar, është pasojë e një procesi gjyqësor të parregullt, të zhvilluar në mungesën time.*
- *Arsyetimi i Gjykatës Administrative të Apelit, se falciteti i dëftesës së komunikimit, nuk provohet të ketë nisur një procedim penal për postierin, nuk qëndron pasi postieri është dënuar me vendimin nr.352 datë 09.02.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.*
- *Mbi bazën e këtij vendimi është kërkuar edhe rishikim në Gjykatën e Lartë dhe mban nr.02155-002017 datë 24.07.2017 dhe është në pritje të shqyrtimit.*
- *Ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda dhe të pariparueshme për familjen e tij.*

## II- VLERËSIMI I KOLEGJIT ADMINISTRATIV TË GJYKATËS SË LARTË

9- Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

10- Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atçastshëm dhe eminent për shkakimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

11- Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

*“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:*

*a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose*

*b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.*

12- Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- *ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të pariparueshëm dhe të atçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;*
- *(nuk) cenohet rëndë interesi publik.*

13- Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.



14- Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentat e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

15- Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore pasjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashkuar nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjësisë personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

16- Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në funksion të zgjidhjes së çështjes konkrete, vlerëson se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë e paraqitur nga pala e paditur, Alfred Bej, është e pabazuar në ligj dhe si e tillë nuk duhet të pranohet.

17- Ky Kolegj vëren se, në zbatim të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, bashkëlidhur kërkesës për pezullim të palës kërkuese Alfred Bej, gjendet edhe kopja e rekursit të ushtruar nga kjo palë kundër vendimit gjyqësor që kërkohet të pezullohet ekzekutimit.

18- Gjithashtu, ky Kolegj vëren se palët e tjera pjesëmarrëse në gjykimin e çështjes ku është dhënë vendimi gjyqësor që kërkohet të pezullohet, janë njoftuar rregullisht për kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese Alfred Bej, të cilat nuk kanë parashtruar argumente lidhur me bazueshmërinë në ligj të kërkesës për pezullim dhe për qëndrimin e tyre.

19- Nga shqyrtimi i shkaqeve konkrete për të cilat pala kërkuese Alfred Bej kërkon pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, Kolegji Administrativ vlerëson se, kjo Kërkesë, në tërësinë e saj, motivohet me shkaqe që kanë të bëjnë vetëm me drejtësinë, bazueshmërinë në prova dhe në ligj, të vendimeve të dhëna nga gjykata administrative e shkallës së parë dhe ajo e Apelit në zgjidhjen e çështjes, të cilat ky Kolegj i vlerëson në kohën kur shqyrton në dhomë këshillimi shkaqet e rekursit ndaj vendimit të gjykatës administrative të apelit.

20- Për sa i përket motivit të fundit dhe të vetëm, që formalisht përfshihet në rastin e shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, Kolegji Administrativ vëren se pala kërkuese Alfred Bej nuk ka paraqitur asnjë provë dhe nuk ka arsyetuar lidhur me ndonjë rrethanë konkrete për ta vlerësuar nëse jemi ose jo përpara rastit kur Gjykata e Lartë mund të konkludojë se nga ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit gjyqësor do të vinin pasoja të rënda financiare për palën kërkuese Alfred Bej.

21- Kolegji Administrativ vlerëson të evidentojë se, duke mbajtur parasysh edhe natyrën e mosmarrëveshjes mes palëve, pozitën e palës kreditore dhe asaj debitore, si edhe

natyrën dhe vlerën e detyrimeve që kërkohet të ekzekutohen në çështjen konkrete në shqyrtim, në interpretim dhe zbatim të drejtë të ligjit procedural, mbetet thjesht një kërkim dhe pretendim hipotetik dhe, si i tillë, i pambështetur në ligj, vetëm parashtrimi formal i pretendimit (shkakut) se ekzekutimi mund të sjellë pasoja të rënda financiare, si një shkak që e përcakton vetë neni 479 pika 1 shkronja “a” e Kodit të Procedurës Civile, pa parashtruar njëkohësisht edhe argumenta dhe shpjegime konkrete lidhur me rrethanat që tregojnë mundësinë e ardhjes së tyre.

22- Ky Kolegj, vlerëson të theksojë gjithashtu se nga ana e palës kërkuese nuk është respektuar edhe paragrafi 1 pika “b” i nenit 479 të K.Pr.Civile, pasi nuk është depozituar garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit, e cila çon automatikisht në rrëzimin e kërkesës si të pambështetur në ligj.

23- Për sa më sipër, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se nuk ka vend për të pranuar kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese Alfred Bej, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.560, datë 26.02.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë dhe vendimin nr.5706, datë 11.11.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

### **PËR KËTO ARSYE**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 1 pika 2 e ligjit nr.49/2012 “*Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative*” dhe nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile;

### **V E N D O S I**

Mospranimin e kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.560, datë 26.02.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë dhe vendimit nr.5706, datë 11.11.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të paraqitur nga Alfred Bej.

**Tiranë, më datë 08.06.2020**

**ANËTAR**  
**Ilir PANDA**

**ANËTAR**  
**Ervin PUPE**

**KRYESUES**  
**Sokol SADUSHI**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E LARTË  
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

**Nr. 23/290 i Vendimit.**

**V E N D I M**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

**Sokol SADUSHI - Kryesues**  
**Ervin PUPE - Anëtar**  
**Ilir PANDA - Anëtar**

Në datën 08.06.2020, mori në shqyrtim në dhomën e këshillimit çështjen administrative, që u përket palëve:

**KËRKUES:** Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

**OBJEKTI:** Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr.173, datë 28.01.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

**BAZA LIGJORE:** Neni 479/a/2 të Kodit të Procedurës Civile

**Në çështjen me :**

**PADITËS:** Arbana Shehu

**PADITUR:** Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

**KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË**

Pasi dëgjoji relacionin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe diskutoi çështjen në tërësi në dhomën e këshillimit,

**VËREN**

**I- RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1- Nga aktet e administruara në praktikën gjyqësore, rezulton se pala paditëse Arbana Shehu, me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.681 datë 27.02.2013, ka marrë gradën “Kryekomisar” dhe është emëruar si Shefe e Seksionit të Testimeve dhe më pas është transferuar në një tjetër pozicion ekuivalent me të njëjtën gradë.

2- Nga ana e palës së paditur Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, me urdhërin nr.1756 datë 23.06.2015 është transferuar në pozicionin e “Specialistes në Sektorit të Trajnimeve..”, pozicioni i cili nuk ka gradën e paditëse, e cila e ruan këtë gradë për një vit dhe nëse rikthehet në një pozicion me të njëjtën gradë.

3- Për sa më sipër, paditësi duke pretenduar se pala e paditur ka vepruar në kundërshtim me ligjin, i është drejtuar gjykatës me padinë objekt gjykimi.

4- **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë**, me vendimin nr.5353, datë 26.10.2015 ka vendosur:  
Rrëzimin e kërkesë padisë si të pabazuar në ligj dhe në prova.

5- **Gjykata Administrative e Apelit Tiranë**, me vendimin nr.173, datë 28.01.2019 ka vendosur:  
Ndryshimin e vendimit nr.5353, datë 26.10.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.  
Pranimin e padisë.  
Shfuqizimin e aktit administrativ urdhër nr.1756 datë 23.06.2015 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit “Për transferimin dhe emërimin në detyrë të një punonjësi policie”.  
Detyrimin e palës së paditur të kthejë paditësen në një pozicion pune me gradën “kryekomisar” të fituar nga paditësja konform ligjit.

6- Më datë **16.05.2019** Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në thelb parashtron sa vijon:

- *Drejtoria e Përgjithshme e Policisë në bazë të nenit 472 të K.Pr.Civile ka ushtruar rekurs pranë Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, duke kërkuar prishjen e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të shkallës së parë Tiranë.*
- *I gjithë kuadri ligjor mbi organizimin dhe funksionimin e Policisë , e veçanërisht mbi procedurat e ngritjes në gradë, e të konkurimit për këtë të fundit, është i ndërtuar mbi lidhjen e ngushtë detyrë funksionale – gradë.*
- *Akordimi i gradës “Kryekomisar”, përmes këtij vendimi gjyqësor, jo vetëm bie në kundërshtim flagrant me ligjin , por sjellë injorim total që i bën gjykata procesit të konkurimit në gradë mbi bazën e vjetërsisë në shërbim dhe meritës profesionale që disponon secili punonjës policie.*
- *Ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda ekonomike ashtu edhe administrative.*

## **II- VLERËSIMI I KOLEGJIT ADMINISTRATIV TË GJYKATËS SË LARTË**

7- Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi

masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

8- Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atëçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të riparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

9- Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

*“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:*

*a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të riparueshme; dhe/ose*

*b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin e vendimit.”.*

10- Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- *ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të riparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;*
- *(nuk) cenohet rëndë interesi publik.*

11- Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

12- Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit

gjqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentat e parashtuara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

13- Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashikuar nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjësisë personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

14- Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në funksion të zgjidhjes së çështjes konkrete, vlerëson se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë e paraqitur nga pala e paditur, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, është e pabazuar në ligj dhe si e tillë nuk duhet të pranohet.

15- Ky Kolegj vëren se, në zbatim të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, bashkëlidhur kërkesës për pezullim të palës kërkuese Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, gjendet edhe kopja e rekursit të ushtruar nga kjo palë kundër vendimit gjyqësor që kërkohet të pezullohet ekzekutimit.

16- Gjithashtu, ky Kolegj vëren se palët e tjera pjesëmarrëse në gjykimin e çështjes ku është dhënë vendimi gjyqësor që kërkohet të pezullohet, janë njoftuar rregullisht për kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, të cilat nuk kanë parashtuar argumente lidhur me bazueshmërinë në ligj të kërkesës për pezullim dhe për qëndrimin e tyre.

17- Nga shqyrtimi i shkaqeve konkrete për të cilat pala kërkuese Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit kërkon pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, Kolegji Administrativ vlerëson se, kjo Kërkesë, në tërësinë e saj, motivohet me shkaqe që kanë të bëjnë vetëm me drejtësinë, bazueshmërinë në prova dhe në ligj, të vendimeve të dhëna nga gjykata administrative e shkallës së parë dhe ajo e Apelit në zgjidhjen e çështjes, të cilat ky Kolegj i vlerëson në kohën kur shqyrton në dhomë këshillimi shkaqet e rekursit ndaj vendimit të gjykatës administrative të apelit.

18- Për sa i përket motivit të fundit dhe të vetëm, që formalisht përfshihet në rastin e shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, Kolegji Administrativ vëren se pala kërkuese Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit nuk ka paraqitur asnjë provë dhe nuk ka arsyetuar lidhur me ndonjë rrethanë konkrete për ta vlerësuar nëse jemi ose jo përpara rastit kur Gjykata e Lartë mund të konkludojë se nga ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit gjyqësor do të vinin pasoja të rënda financiare për palën kërkuese Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

19- Kolegji Administrativ vlerëson të evidentojë se, duke mbajtur parasysh edhe natyrën e mosmarrëveshjes mes palëve, pozitën e palës kreditore dhe asaj debitore, si edhe natyrën dhe vlerën e detyrimeve që kërkohet të ekzekutohen në çështjen konkrete në shqyrtim, në interpretim dhe zbatim të drejtë të ligjit procedural, mbetet thjesht një kërkim dhe pretendim hipotetik dhe, si i tillë, i pambështetur në ligj, vetëm parashtrimi formal i

pretendimit (shkakut) se ekzekutimi mund të sjellë pasoja të rënda financiare, si një shkak që e përcakton vetë neni 479 pika 1 shkronja “a” e Kodit të Procedurës Civile, pa parashtruar njëkohësisht edhe argumenta dhe shpjegime konkrete lidhur me rrethanat që tregojnë mundësinë e ardhjes së tyre.

20- Për sa më sipër, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se nuk ka vend për të pranuar kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.173, datë 28.01.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

### **PËR KËTO ARSYE**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 1 pika 2 e ligjit nr.49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative” dhe nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile

### **V E N D O S I**

Mospranimin e kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.173, datë 28.01.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, të paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

**Tiranë, më datë 08.06.2020**

**ANËTAR**  
**Ilir PANDA**

**ANËTAR**  
**Ervin PUPE**

**KRYESUES**  
**Sokol SADUSHI**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E LARTË  
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

**Nr. 45/327 i Vendimit**

**V E N D I M**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

**Sokol SADUSHI - Kryesues**  
**Ervin PUPE - Anëtar**  
**Ilir PANDA - Anëtar**

Në datën 08.06.2020, mori në shqyrtim në dhomën e këshillimit çështjen administrative, që u përket palëve:

**KËRKUES:** Avokatura e Shtetit dhe Agjencia e Trajtimit të Pronave  
**OBJEKTI:** Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr.59, datë 18.03.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.  
**BAZA LIGJORE:** Neni 479 të Kodit të Procedurës Civile  
**Në çështjen me :**  
**PADITËS:** Isuf Bodo  
**PADITUR:** Agjencia e Trajtimit të Pronave

**KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË**

Pasi dëgjoi relacionin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe diskutoi çështjen në tërësi në dhomën e këshillimit,

**VËREN**

**I- RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1- Nga aktet e administruara në praktikën gjyqësore, rezulton se pala paditëse Isuf Bodo, është një nga trashëgimtarët ligjor të të ndjerit Sadik Bodo, të cilëve u është njohur e drejta e pronësisë mbi sipërfaqen 4304.5 m2 dhe e drejta e kompensimit për 8523.50 m2.



2- Nga ana e palës së paditur Agjencia e Trajtimit të Pronave, është bërë vlerësimi financiar i pasurive të sipërcituar dhe i është njohur e drejta e kompensimit për sipërfaqen e sipërcituar duke iu referuar nenit 7 pika 2/a të ligjit nr.133/2015.

3- Për sa më sipër, paditësi duke pretenduar se pala e paditur ka vepruar në kundërshtim me ligjin, i është drejtuar gjykatës me padinë objekt gjykimi.

4- **Gjykata Administrative e Apelit Tiranë**, me vendimin nr.59, datë 18.03.2019 ka vendosur:

Pranimin e padisë.

Ndryshimin e vlerësimit të kompensimit financiar të bërë nga pala e paditur Agjencia e Trajtimit të Pronave ndaj vendimit nr.38 datë 18.05.1994 të ish KKKP Vlorë të ndryshuar me vendimin nr.3833/22 datë 25.06.2009 nga AKKP Tiranë që i përket ish subjektit Sadik Bodo, duke bërë rivlerësimin financiar për sipërfaqen 8523.50 m<sup>2</sup> nga zë kadastral “arë” në zë kadastral “truall”.

5- Më datë **12.06.2019** Avokatura e Shtetit, ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në thelb parashtron sa vijon:

- *Vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit është marrë në interpretim të gabuar të ligjit nr.133/2015 dhe në shkelje të rënda të normave procedurale.*
- *Duke i'u referuar nenit 6/1/a dhe VKM nr.223/2016, pala e paditur ka konstatuar se zëri kadastral i origjinës për pronën e njohur ka qenë tokë bujqësore dhe sipas hartës vlera e tokës bujqësore në ZK1173 është 204 lekë/m<sup>2</sup>.*
- *Akti i ekspertimit është realizuar me kërkesë të palës paditëse, është akti i njëanshëm dhe gjykata nuk duhej ta analizonte dhe në vlerësim ti referohej këtyre konkluzioneve.*
- *Ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda për palën e paditur.*

6- Më datë **01.06.2019** Agjencia e Trajtimit të Pronave, ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në thelb parashtron sa vijon:

- *Ligji nr.133/2015 ka përcaktuar se kur është ushtruar rekurs vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit bëhet përfundimtar dhe i ekzekutueshëm sipas ligjit kur ka përfunduar shqyrtimi i rekursit në Gjykatë të Lartë .*
- *Ligji nr.133/2015 ka qenë objekt shqyrtimi në Gjykatën Kushtetuese, e cila nuk ka konstatuar konflikte midis normave dhe ligji i posaçëm ka epërsi ndaj rregullave të përgjithshme.*
- *ATP ka kryer vlerësimin financiar sipas metodologjisë së vlerësimeve të vendimeve të ish KKKP, në referim të nenit 7 pika 2/a.*
- *Ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda për palën e paditur.*

## **II- VLERËSIMI I KOLEGJIT ADMINISTRATIV TË GJYKATËS SË LARTË**

7- Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi

masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

8- Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të riparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

9- Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

*“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:*

*a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të riparueshme; dhe/ose*

*b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin e vendimit.”.*

10- Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- *ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të riparueshëm dhe të atçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;*
- *(nuk) cenohet rëndë interesi publik.*

11- Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

12- Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit

gjqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentat e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

13- Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashikuar nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjësive personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

14- Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në funksion të zgjidhjes së çështjes konkrete, vlerëson se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë e paraqitur nga pala e paditur, Avokatura e Shtetit dhe Agjencia e Trajtimit të Pronave, është e pabazuar në ligj dhe si e tillë nuk duhet të pranohet.

15- Duke iu rikthyer rastit konkret, kërkuesi, ka kërkuar pezullimin e ekzekutimit të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, e cila ka ushtruar juridiksion fillestar dhe ka disponuar mbi një vendim të Agjencisë së Trajtimit të Pronës, bazuar në Ligjin nr. 133/2015 “Për Trajtimin e Pronës dhe Përfundimin e Procesit të Kompensimit të Pronave” (në vijim Ligji nr. 133/2015).

16. Kolegji vlerëson se Ligji nr. 133/2015 është me natyrë mikse, sepse përmban norma juridike të karakterit material dhe procedural. Dispozitat materiale përcaktojnë rregullat dhe kriteret mbi bazën e të cilave organi administrativ kompetent (konkretisht ATP), e më tej gjykata do të vendosë mbi kërkesat e ish-pronarëve për njohje dhe kompensim të pronës. Nga ana tjetër, dispozitat procedurale disjelojnë në mënyrë të posaçme (lex specialis), veprimtarinë e organit administrativ përgjegjës për trajtimin e kërkesave të ish-pronarëve për kompensim të pronës, afatet e veprimit administrativ, të drejtën ankimit dhe afatet e ankimit të subjekteve të procedimit administrativ, për të kundërshtuar vendimet e ATP-së në gjykatë, kompetencën e gjykatave që do të shqyrtojnë këto mosmarrëveshje etj. Në mënyrë të posaçme, ky ligj i ka njohur juridiksion fillestar gjykatave të apelit dhe Gjykatës Administrative të Apelit, sipas neneve 19 dhe 29, kur objekt kontrolli kanë qenë vendime të ATP-së, vendime të ish-KKKP-ve, ish-ZRVKKP-ve apo ish-AKKP-së, që kanë disponuar në lidhje me kërkesën e ish-pronarëve, për njohjen, kthimin apo kompensimin e pronës. (Vendim Njësues nr. 611, datë 07.02.2018 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë).

17. Në vijim të këtij arsyetimi, Kolegji sjell në vëmendje nenin 5/17 të Ligjit nr. 133/2015, nën titullin “**Përkufizime**”, ku është parashikuar se: “...Vendim “përfundimtar” është çdo vendim administrativ ose gjyqësor, i cili nuk i nënshtrohet më një procedure kontrolli dhe rishikimi nga një autoritet më i lartë administrativ ose gjyqësor, duke përfshirë këtu vendimet e formës së prerë dhe kur këto i janë nënshtruar rekursit, si përfundimtar konsiderohet vendimi i Gjykatës së Lartë...” Kjo dispozitë me natyrë procedurale përcakton se kur vendimi gjyqësor merr formë të prerë dhe bëhet i ekzekutueshëm për qëllime të këtij ligji, në rastin kur mosmarrëveshja midis ish-pronarit dhe shtetit i nënshtrohet juridiksionit gjyqësor. Nga ana tjetër, Kolegji thekson se, kjo dispozitë, për situatën kur gjykata e apelit ka ushtruar juridiksion fillestar, është në harmoni edhe me parashikimin e përgjithshëm të nenit 451 të K.Pr.Civile (lex generalis), sipas të cilit vendimi i gjykatës merr formë të prerë, ndër të

tjera, kur është vendosur lënia në fuqi, ndryshimi i vendimit apo është vendosur pushimi i gjykimit në shkallë të dytë (pika ç). Sipas kësaj dispozite vendimi i gjykatës merr formë të prerë pas një procesi gjyqësor dy shkallësh, si rrjedhojë vendimi i gjykatës së apelit civil apo administrativ, në rastet kur gjykata e apelit ushtron juridiksion fillestar, (apo e thënë ndryshe ka gjykuar si shkallë e parë) dhe ndaj vendimit është ushtruar rekurs, nuk mund të konsiderohet si vendim gjyqësor i formës së prerë. Rekursi në këtë rast ka sjellë efektet juridike të parandalimit të marrjes formë të prerë. Si rrjedhojë, vendimi i gjykatës së apelit do të marrë formë të prerë pasi të përfundojë shqyrtimi i rekursit në Gjykatën e Lartë, si shkalla e dytë e gjykimit.

18. Bazuar në arsyetimin e mësipërm, në rastin konkret, kërkesa e kërkuarit është pa objekt sepse paraqitja e rekursit ka ipso iure efekte pezulluese për vendimin e dhënë nga Gjykata Administrative e Apelit. Ky i fundit në rastin konkret nuk është i formës së prerë dhe sikurse u arsyetua më sipër nën 479 i K.Pr.Civile fushën e zbatimit e ka vetëm për vendimet objekt rekursi të gjykatës së apelit me juridiksion rishikues.

19. Kolegji vlerëson të rëndësishme të theksojë se nuk ka patur një praktikë të qartë në lidhje me interpretimin e Ligjit nr. 133/2015, në raport me nenin 451 të K.Pr.Civile, në raste të tilla, në lidhje me çështjen nëse janë apo jo të formës së prerë vendimet e gjykatave të apelit me juridiksion fillestar. Kolegji vlerëson se qëndrimi i mbajtur në rastin konkret, sipas të cilit vendimet e gjykatave civile të apelit apo të Gjykatës Administrative të Apelit me juridiksion fillestar sipas Ligjit nr. 133/2015, do të jetë i zbatueshëm edhe për rastet e ngjashme në të ardhmen (pro futuro). Si rrjedhojë Kolegji thekson se çdo kërkesë e palëve në të ardhmen për pezullimin e ekzekutimit të vendimit sipas nenit 479 të K.Pr.Civile në raste të tilla do të vlerësohet në kuptim të kërkesave të parashikuara në nenin 34 të K.Pr.Civile të ndryshuar.

20- Për sa më sipër, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se nuk ka vend për të pranuar kërkesën e paraqitur nga pala kërkuare Avokatura e Shtetit dhe Agjencia e Trajtimit të Pronave, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.59, datë 18.03.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

## **PËR KËTO ARSYE**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 1 pika 2 e ligjit nr.49/2012 “*Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative*” dhe nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile;

## **V E N D O S I**

Mospranimin e kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.59, datë 18.03.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, të paraqitur nga Avokatura e Shtetit dhe Agjencia e Trajtimit të Pronave.

**Tiranë, më datë 08.06.2020**

**ANËTAR**  
**Ilir PANDA**

**ANËTAR**  
**Ervin PUPE**

**KRYESUES**  
**Sokol SADUSHI**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E LARTË  
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

**Nr. 56/348 i Vendimit**

**V E N D I M**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

**Sokol SADUSHI - Kryesues**  
**Ervin PUPE - Anëtar**  
**Illir PANDA - Anëtar**

Në datën 08.06.2020, mori në shqyrtim në dhomën e këshillimit çështjen administrative, që u përket palëve:

**KËRKUES:** Avokatura e Shtetit

**OBJEKTI:** Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr.117, datë 13.05.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

**BAZA LIGJORE:** Neni 479 të Kodit të Procedurës Civile

**Në çështjen me :**

**PADITËS:** Sulejman Maqi

**PADITUR:** Agjencia e Trajtimit të Pronave

**KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË**

Pasi dëgjoji relacionin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe diskutoi çështjen në tërësi në dhomën e këshillimit,

**VËREN**

**I- RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1- Nga aktet e administruara në praktikën gjyqësore, rezulton se pala paditëse Sulejman Maqi, është një nga trashgimtarët ligjor të të ndjerve Mehmet dhe Zogë Maqi, të cilëve u është njohur e drejta e pronësisë mbi sipërfaqen 2035 m2 tokë në fashtin Ganjoll

kategoria V=13.5 lekë; 2786 m2 në fashtin Shelqet kategoria IV=17.1 lekë; 3510 m2 në fashtin Berditce kategoria III=21 lekë.

2- Nga ana e palës së paditur Agjencia e Trajtimit të Pronave, është bërë vlerësimi financiar i pasurive të sipërcituar dhe i është njohur e drejta e kompensimit për sipërfaqen 5831 m2 me vlerën totale 144.518 lekë.

3- Për sa më sipër, paditësi duke pretenduar se pala e paditur ka vepruar në kundërshtim me ligjin, i është drejtuar gjykatës me padinë objekt gjykimi.

4- **Gjykata Administrative e Apelit Tiranë**, me vendimin nr.117, datë 13.05.2019 ka vendosur:

Pranimin e pjeshëm të padisë.

Shfuqizimin e vlerësimit financiar të publikuar në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare nr.30 datë 06.08.2018 për vendimin nr.345 datë 10.01.2003 të ish Komisionit të Kthimit të Pronave të Këshillit të Rrethit Shkodër për subjektin e shpronësuar Mehmet Maqi.

Detyrimin e ATP të kryejë vlerësimin financiar të këtij vendimi sipas kërkesave të ligjit nr.133/2015.

Rrëzimin për pjesën tjetër të kërtimeve.

5- Më datë **02.07.2019** Avokatura e Shtetit, ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në thelb parashtron sa vijon:

- *Vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit është marrë në interpretim të gabuar të ligjit nr.133/2015 dhe në shkelje të rënda të normave procedurale.*
- *Duke i'u referuar kërkesë padisë objekt gjykimi është kontradiktor dhe i pabazuar në nenin 19 të ligjit nr.133/2015, pasi kjo padi është e parashkruar.*
- *Vlerësimi i pronës është bërë mbi parashikimet e ligjit nr.133/2015, i cili pranohet edhe nga gjykata por ajo tejkalon parashikimet kur thekson se paditësi legjitmohet të kundërshtojë vlerën financiare dhe jo metodologjinë.*
- *Ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda dhe do të njihet paditësit një vlerësim të pabazuar.*

## **II- VLERËSIMI I KOLEGJIT ADMINISTRATIV TË GJYKATËS SË LARTË**

6- Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

7- Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të

ekzistojë një rrezik i atçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

8- Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

*“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:*

*a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose*

*b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.*

9- Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykim i administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- *ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të pariparueshëm dhe të atçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;*
- *(nuk) cenohet rëndë interesi publik.*

10- Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

11- Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentat e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

12- Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore pasjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashkuar

nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjësive personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

13- Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në funksion të zgjidhjes së çështjes konkrete, vlerëson se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë e paraqitur nga pala e paditur, Avokatura e Shtetit, është e pabazuar në ligj dhe si e tillë nuk duhet të pranohet.

14- Duke iu rikthyer rastit konkret, kërkuesi, ka kërkuar pezullimin e ekzekutimit të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, e cila ka ushtruar juridiksion fillestar dhe ka disponuar mbi një vendim të Agjensisë së Trajtimit të Pronës, bazuar në Ligjin nr. 133/2015 “Për Trajtimin e Pronës dhe Përfundimin e Procesit të Kompensimit të Pronave” (në vijim Ligji nr. 133/2015).

15. Kolegji vlerëson se Ligji nr. 133/2015 është me natyrë mikse, sepse përmban norma juridike të karakterit material dhe procedural. Dispozitat materiale përcaktojnë rregullat dhe kriteret mbi bazën e të cilave organi administrativ kompetent (konkretisht ATP), e më tej gjykata do të vendosë mbi kërkesat e ish-pronarëve për njohje dhe kompensim të pronës. Nga ana tjetër, dispozitat procedurale disiplinon në mënyrë të posaçme (lex specialis), veprimtarinë e organit administrativ përgjegjës për trajtimin e kërkesave të ish-pronarëve për kompensim të pronës, afatet e veprimit administrativ, të drejtën ankimit dhe afatet e ankimit të subjekteve të procedimit administrativ, për të kundërshtuar vendimet e ATP-së në gjykatë, kompetencën e gjykatave që do të shqyrtojnë këto mosmarrëveshje etj. Në mënyrë të posaçme, ky ligj i ka njohur juridiksion fillestar gjykatave të apelit dhe Gjykatës Administrative të Apelit, sipas neneve 19 dhe 29, kur objekt kontrolli kanë qënë vendime të ATP-së, vendime të ish-KKKP-ve, ish-ZRVKKP-ve apo ish-AKKP-së, që kanë disponuar në lidhje me kërkesën e ish-pronarëve, për njohjen, kthimin apo kompensimin e pronës. (Vendim Njësues nr. 611, datë 07.02.2018 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë).

16. Në vijim të këtij arsytimi, Kolegji sjell në vëmendje nenin 5/17 të Ligjit nr. 133/2015, nën titullin “**Përkufizime**”, ku është parashikuar se: “...Vendim “përfundimtar” është çdo vendim administrativ ose gjyqësor, i cili nuk i nënshtrohet më një procedure kontrolli dhe rishikimi nga një autoritet më i lartë administrativ ose gjyqësor, duke përfshirë këtu vendimet e formës së prerë dhe kur këto i janë nënshtruar rekursit, si përfundimtar konsiderohet vendimi i Gjykatës së Lartë...” Kjo dispozitë me natyrë procedurale përcakton se kur vendimi gjyqësor merr formë të prerë dhe bëhet i ekzekutueshëm për qëllime të këtij ligji, në rastin kur mosmarrëveshja midis ish-pronarit dhe shtetit i nënshtrohet juridiksionit gjyqësor. Nga ana tjetër, Kolegji thekson se, kjo dispozitë, për situatën kur gjykata e apelit ka ushtruar juridiksion fillestar, është në harmoni edhe me parashikimin e përgjithshëm të nenit 451 të K.Pr.Civile (lex generalis), sipas të cilit vendimi i gjykatës merr formë të prerë, ndër të tjera, kur është vendosur lënia në fuqi, ndryshimi i vendimit apo është vendosur pushimi i gjykimit në shkallë të dytë (pika ç). Sipas kësaj dispozite vendimi i gjykatës merr formë të prerë pas një procesi gjyqësor dy shkallësh, si rrjedhojë vendimi i gjykatës së apelit civil apo administrativ, në rastet kur gjykata e apelit ushtron juridiksion fillestar, (apo e thënë ndryshe ka gjykuar si shkallë e parë) dhe ndaj vendimit është ushtruar rekurs, nuk mund të konsiderohet si vendim gjyqësor i formës së prerë. Rekursi në këtë rast ka sjellë efektet juridike të parandalimit të marrjes formë të prerë. Si rrjedhojë, vendimi i gjykatës së apelit do të marrë formë të prerë pasi të përfundojë shqyrtimi i rekursit në Gjykatën e Lartë, si shkalla e dytë e gjykimit.



17. Bazuar në arsyetimin e mësipërm, në rastin konkret, kërkesa e kërkuarit është pa objekt sepse paraqitja e rekursit ka ipso iure efekte pezulluese për vendimin e dhënë nga Gjykata Administrative e Apelit. Ky i fundit në rastin konkret nuk është i formës së prerë dhe sikurse u arsyetua më sipër nën 479 i K.Pr.Civile fushën e zbatimit e ka vetëm për vendimet objekt rekursi të gjykatës së apelit me juridiksion rishikues.

18. Kolegji vlerëson të rëndësishme të theksojë se nuk ka patur një praktikë të qartë në lidhje me interpretimin e Ligjit nr. 133/2015, në raport me nenin 451 të K.Pr.Civile, në raste të tilla, në lidhje me çështjen nëse janë apo jo të formës së prerë vendimet e gjykatave të apelit me juridiksion fillestar. Kolegji vlerëson se qëndrimi i mbajtur në rastin konkret, sipas të cilit vendimet e gjykatave civile të apelit apo të Gjykatës Administrative të Apelit me juridiksion fillestar sipas Ligjit nr. 133/2015, do të jetë i zbatueshëm edhe për rastet e ngjashme në të ardhmen (pro futuro). Si rrjedhojë Kolegji thekson se çdo kërkesë e palëve në të ardhmen për pezullimin e ekzekutimit të vendimit sipas nenit 479 të K.Pr.Civile në raste të tilla do të vlerësohet në kuptim të kërkesave të parashikuar në nenin 34 të K.Pr.Civile të ndryshuar.

19- Për sa më sipër, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se nuk ka vend për të pranuar kërkesën e paraqitur nga pala kërkuare Avokatura e Shtetit, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.117, datë 13.05.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

### **PËR KËTO ARSYE**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 1 pika 2 e ligjit nr.49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative” dhe nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile;

### **V E N D O S I**

Mospranimin e kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.117, datë 13.05.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, të paraqitur nga Avokatura e Shtetit.

Tiranë, më datë 08.06.2020

**ANËTAR**  
**Ilir PANDA**

**ANËTAR**  
**Ervin PUPE**

**KRYESUES**  
**Sokol SADUSHI**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E LARTË  
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

**Nr. 76/391 i Vendimit.**

**V E N D I M**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

**Sokol SADUSHI - Kryesues**

**Ervin PUPE - Anëtar**

**Ilir PANDA - Anëtar**

Në datën 08.06.2020, mori në shqyrtim në dhomën e këshillimit çështjen administrative, që u përket palëve:

**KËRKUES:** Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura

**OBJEKTI:** Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr.2157, datë 09.07.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

**BAZA LIGJORE:** Neni 479 të Kodit të Procedurës Civile

**Në çështjen me :**

**PADITËS:** Aida Gojani

**PADITUR:** Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura.

**KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË**

Pasi dëgjoi relacionin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe diskutoi çështjen në tërësi në dhomën e këshillimit,

**VËREN**

**I- RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1- Nga aktet e administruara në praktikën gjyqësore, rezulton se pala paditëse Aida Gojani, me Vendim të Këshillit të Ministrave nr.527 datë 02.08.2006 është emëruar anëtare e Komisionit Kombëtar të Entit Rregullator të Ujit, për një mandat 4 vjeçar, mandat ky i cili është rinovuar përsëri me VKM nr.667 datë 04.08.2010.

2- Nga ana e palës së paditur Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura, mbasi është përfunduar mandati i palës paditëse ka bërë edhe ndërprerjen e marrëdhënieve financiare.

3- Për sa më sipër, paditësi duke pretenduar se pala e paditur ka vepruar në kundërshtim me ligjin, duke mos i dhënë 4 paga për shkak të vjetërsisë në punë, i është drejtuar gjykatës me padinë objekt gjykimi.

4- **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë**, me vendimin nr.833, datë 20.02.2015 ka vendosur:  
Rrëzimin e kërkesë padisë me nr.9411/1478 akti me paditëse Aida Gojani.

5- **Gjykata Administrative e Apelit Tiranë**, me vendimin nr.2157, datë 09.07.2019 ka vendosur:

Ndryshimin e vendimit nr.833, datë 20.02.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Pranimin e padisë.

Detyrimin e palës së paditur Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura, që t'i paguajë paditëses Aida Gojani shpërblimin për vjetërsi në punë në masën 4 (katër) paga mujore.

6- Më datë **09.08.2019** Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura, ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në thelb parashtron sa vijon:

- *Sipas nenit 10 të ligjit nr.8102, burimet financiare të palës kërkuese janë pagesat e vendosura nga ai vetë për operatorët e sistemeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, pagesat e licensave dhe donacionet e ndryshme.*
- *Sipas nenit 11 të ligjit nr.8102 është parashikuar se “jo më vonë se 3 muaj para fillimit të çdo viti fiskal Enti Rregullator do të ndërtojë një fond të shpenzimeve të parashikuara operative për t’ia paraqitur për miratim Këshillit të Ministrave”.*
- *Me shkresën nr.10055/3 prot., datë 20.08.2014 Ministria e Financave refuzon miratimin e shtesës së fondit të kërkuar dhe se mënyra e trajtimit të anëtarëve të Komisionit Kombëtar Rregullator të Entit, në lidhje me pagat dhe shpërblimet rregullohen nga ligji nr.9584 datë 17.07.2006 dhe se nuk parashikohet shpërblim në përfundim të mandatit për vjetërsi në punë.*
- *Ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda financiare.*

## **II- VLERËSIMI I KOLEGJIT ADMINISTRATIV TË GJYKATËS SË LARTË**

7- Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi

masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

8- Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atëcastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të riparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

9- Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

*“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:*

*a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të riparueshme; dhe/ose*

*b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin e vendimit.”.*

10- Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- *ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të riparueshëm dhe të atëcastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;*
- *(nuk) cenohet rëndë interesi publik.*

11- Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

12- Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit

gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentat e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

13- Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashikuar nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjësisë personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

14- Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në funksion të zgjidhjes së çështjes konkrete, vlerëson se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë e paraqitur nga pala e paditur, Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura, është e pabazuar në ligj dhe si e tillë nuk duhet të pranohet.

15- Ky Kolegj vëren se, në zbatim të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, bashkëlidhur kërkesës për pezullim të palës kërkuese Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura, gjendet edhe kopja e rekursit të ushtruar nga kjo palë kundër vendimit gjyqësor që kërkohet të pezullohet ekzekutimit.

16- Gjithashtu, ky Kolegj vëren se palët e tjera pjesëmarrëse në gjykimin e çështjes ku është dhënë vendimi gjyqësor që kërkohet të pezullohet, janë njoftuar rregullisht për kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpubimit të Ujërave të Ndotura, të cilat nuk kanë parashtruar argumente lidhur me bazueshmërinë në ligj të kërkesës për pezullim dhe për qëndrimin e tyre.

17- Nga shqyrtimi i shkaqeve konkrete për të cilat pala kërkuese Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura kërkon pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, Kolegji Administrativ vlerëson se, kjo Kërkesë, në tërësinë e saj, motivohet me shkaqe që kanë të bëjnë vetëm me drejtësinë, bazueshmërinë në prova dhe në ligj, të vendimeve të dhëna nga gjykata administrative e shkallës së parë dhe ajo e Apelit në zgjidhjen e çështjes, të cilat ky Kolegj i vlerëson në kohën kur shqyrton në dhomë këshillimi shkaqet e rekursit ndaj vendimit të gjykatës administrative të apelit.

18- Për sa i përket motivit të fundit dhe të vetëm, që formalisht përfshihet në rastin e shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, Kolegji Administrativ vëren se pala kërkuese Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nuk ka paraqitur asnjë provë dhe nuk ka arsyetuar lidhur me ndonjë rrethanë konkrete për ta vlerësuar nëse jemi ose jo përpara rastit kur Gjykata e Lartë mund të konkludojë se nga ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit gjyqësor do të vinin pasoja të rënda financiare për palën kërkuese Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura.

19- Kolegji Administrativ vlerëson të evidentojë se, duke mbajtur parasysh edhe natyrën e mosmarrëveshjes mes palëve, pozitën e palës kreditore dhe asaj debitore, si edhe

natyrën dhe vlerën e detyrimeve që kërkohet të ekzekutohen në çështjen konkrete në shqyrtim, në interpretim dhe zbatim të drejtë të ligjit procedural, mbetet thjesht një kërkim dhe pretendim hipotetik dhe, si i tillë, i pambështetur në ligj, vetëm parashtrimi formal i pretendimit (shkakut) se ekzekutimi mund të sjellë pasoja të rënda financiare, si një shkak që e përcakton vetë neni 479 pika 1 shkronja “a” e Kodit të Procedurës Civile, pa parashtruar njëkohësisht edhe argumenta dhe shpjegime konkrete lidhur me rrethanat që tregojnë mundësinë e ardhjes së tyre.

20- Për sa më sipër, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se nuk ka vend për të pranuar kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.2157, datë 09.07.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

### **PËR KËTO ARSYE**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 1 pika 2 e ligjit nr.49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative” dhe nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile

### **V E N D O S I**

Mospranimin e kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.2157, datë 09.07.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, të paraqitur nga Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura.

**Tiranë, më datë 08.06.2020**

**ANËTAR**  
**Ilir PANDA**

**ANËTAR**  
**Ervin PUPE**

**KRYESUES**  
**Sokol SADUSHI**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E LARTË  
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

**Nr. 79/395 i Vendimit**

**V E N D I M**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

**Sokol SADUSHI** - Kryesues  
**Ervin PUPE** - Anëtar  
**Ilir PANDA** - Anëtar

Në datën 08.06.2020, mori në shqyrtim në dhomën e këshillimit çështjen administrative, që u përket palëve:

**KËRKUES:** Autoriteti Rrugor Shqiptar

**OBJEKTI:** Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr.602 (86-2019-667), datë 01.03.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, i cili ka ndryshuar vendimin nr.8704, datë 24.07.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**BAZA LIGJORE:** Neni 479 të Kodit të Procedurës Civile

**Në çështjen me :**

**PADITËS:** Grigor Lengo

**PADITUR:** Autoriteti Rrugor Shqiptar  
Këshilli i Ministrave etj

**PERSON I TRETË:** Shoqëria Veramentia shpk

**KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË**

Pasi dëgjoji relacionin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe diskutoi çështjen në tërësi në dhomën e këshillimit,

**VËREN**

**I- RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1- Nga aktet e administruara në praktikën gjyqësore, rezulton se pala paditëse Grigor Lengo, sipas certifikatave të pronësisë, është pronar i pasurive nr.95/1 me sipërfaqe 1.500 m<sup>2</sup>; nr.95/2 me sipërfaqe 3680 m<sup>2</sup>; nr.95/7 me sipërfaqe 8.020 m<sup>2</sup>.

2- Nga ana e palës së paditur Autoriteti Rrugor Shqiptar, me qëllim ndërtimin e rrugës paralele Tiranë – Vorë (krahu i majtë) ka filluar procedurat e shpronësimit dhe ndër të tjera është prekur edhe pasuria e paditësit me nr.95/1 dhe nr.95/2, pasuri këto të shpronësuara në favor të personit të tretë shoqëria Veramentia shpk.

3- Për sa më sipër, paditësi duke pretenduar se pala e paditur ka vepruar në kundërshtim me ligjin, pasi çmimi shpronësimit nuk është i drejtë, i është drejtuar gjykatës me padinë objekt gjykimi.

4- **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë**, me vendimin nr. 8704, datë 24.07.2013 ka vendosur:

Pranimin e kërkesëpadisë.

Ndryshimin e pjesshëm të V.K.M-së. nr. 308, datë 05.05.2010 “Për shpronësim për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga ndërtimi i rrugës paralele Tiranë-Vorë (krahu i majtë) lidhur me përcaktimin e subjektit të shpronësuar për pasuritë nr. 95/1 dhe 95/2, duke njohur si pronar paditësin Grigor Lengo dhe ndryshimin e pjesshëm të VKM-së nr. 308, datë 05.05.2010 në lidhje me masën e shpërblimit të caktuar për shpronësim për sipërfaqet e shpronësuara të tokës dhe detyrimin e të paditurve ti paguajnë paditësit Grigor Lengo për sipërfaqen 1.499 m<sup>2</sup> në vlerën reale 20.860.000 lekë (149.000 Euro).

5- **Gjykata e Apelit Tiranë**, me vendimin nr. 550, datë 25.02.2014 ka vendosur: Moskompetencën e Gjykatës së Apelit Tiranë për shqyrtimin e çështjes me nr. 5055/2344 Regj. Themeltar, datë regjistrimi 23.10.2013 si dhe dërgimin e saj për kompetencë shqyrtimi Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

6- **Gjykata Administrative e Apelit**, me vendimin nr. 2028, datë 22.05.2014 ka vendosur:

Prishjen e vendimit nr. 8704, datë 24.07.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Dërgimin e çështjes për rishqyrtim Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

7- **Gjykata e Lartë**, me vendimin nr. 00-2015-1426, datë 19.02.2015 ka vendosur: Prishjen e vendimit nr. 2028, datë 22.05.2014 të Gjykatës Administrative të Apelit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në po atë gjykatë, me tjetër trup gjykues.

8- **Gjykata Administrative e Apelit Tiranë**, me vendimin nr.602 (86-2019-667), datë 01.03.2019 ka vendosur:

Ndryshimin e vendimit nr. 8704, datë 24.07.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në këtë mënyrë:

Pranimin e pjesshëm të padisë së paditësi Grigor Lengo.

Detyrimin e palës së paditur Autoriteti Rrugor Shqiptar, të dëmshpërblejë paditësin Grigor Lengo, në shumën prej 16.489.000 (gjashtëmbëdhjetë milion e katërqind e tetëdhjetë e nëntë mijë) lekë, për shpronësimin faktik të sipërfaqes së tokës “truall” prej 1499 m<sup>2</sup>, në pronësi të tij, nga ndërtimi i rrugës paralele Tiranë – Vorë, krahu i majtë.

Rrëzimin e padisë për të paditurit e tjerë dhe pjesën tjetër të kërtimeve si të pabazuara në ligj e prova.



9- Më datë **15.08.2019** Autoriteti Rrugor Shqiptar, ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në thelb parashtron sa vijon:

- *Vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit është i pabazuar në ligj dhe në prova.*
- *Për të kërkuar ndryshimin e një akti administrativ, duhet që ai të ketë sjellë pasoja për paditësin, i cili nuk është ndër subjektet e shpronësuar dhe për këtë shkak ai nuk legjitimohet aktivisht.*
- *Gjykata thotë se jemi përpara një shpronësimi faktit, por paditësi nuk ka kërkuar shpërblimin e dëmit të ardhur nga mosnxjerrja e një vendimi për shpronësim, pra gjykata në kundërshtim me ligjin ka ndryshuar bazën ligjore dhe shkakun e padisë.*
- *Paditësi kërkon që prona e shpronësuar e shoqërisë Veramentia shpk, të njihet ai pronar i shpronësimit, por sipas aktit të ekspertimit rezulton se prona e tij është e papërfshirë në VKM ndërsa prona e shoqërisë Veramentia shpk është shpronësuar me VKM nr.308/2010.*
- *Ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda dhe të pariparueshme, pasi aktualisht nuk ka asnjë mundësi financiare për pagimin e detyrimeve.*

## **II- VLERËSIMI I KOLEGJIT ADMINISTRATIV TË GJYKATËS SË LARTË**

10- Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

11- Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

12- Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

*“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:*

*a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose*

*b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.*

13- Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- *ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të riparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;*
- *(nuk) cenohet rëndë interesi publik.*

14- Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

15- Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentat e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

16- Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashkuar nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjësisë personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

17- Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në funksion të zgjidhjes së çështjes konkrete, vlerëson se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë e paraqitur nga pala e paditur, Autoriteti Rrugor Shqiptar, është e pabazuar në ligj dhe si e tillë nuk duhet të pranohet.

18- Ky Kolegj vëren se, në zbatim të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, bashkëlidhur kërkesës për pezullim të palës kërkuese Autoriteti Rrugor Shqiptar, gjendet edhe kopja e rekursit të ushtruar nga kjo palë kundër vendimit gjyqësor që kërkohet të pezullohet ekzekutimit.

19- Gjithashtu, ky Kolegj vëren se palët e tjera pjesëmarrëse në gjykimin e çështjes ku është dhënë vendimi gjyqësor që kërkohet të pezullohet, janë njoftuar rregullisht për kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese Autoriteti Rrugor Shqiptar, i cili ka parashtruar dhe

argumentuar lidhur me mosbazueshmërinë në ligj të kërkesës për pezullim dhe në thelb të qëndrimit të tij kërkon mospranimin e kërkesës si të pabazuar në ligj.

20- Nga shqyrtimi i shkaqeve konkrete për të cilat pala kërkuese Autoriteti Rrugor Shqiptar kërkon pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, Kolegji Administrativ vlerëson se, kjo Kërkesë, në tërësinë e saj, motivohet me shkaqe që kanë të bëjnë vetëm me drejtësinë, bazueshmërinë në prova dhe në ligj, të vendimeve të dhëna nga gjykata administrative e shkallës së parë dhe ajo e Apelit në zgjidhjen e çështjes, të cilat ky Kolegj i vlerëson në kohën kur shqyrton në dhomë këshillimi shkaqet e rekursit ndaj vendimit të gjykatës administrative të apelit.

21- Për sa i përket motivit të fundit dhe të vetëm, që formalisht përfshihet në rastin e shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, Kolegji Administrativ vëren se pala kërkuese Autoriteti Rrugor Shqiptar nuk ka paraqitur asnjë provë dhe nuk ka arsyetuar lidhur me ndonjë rrethanë konkrete për ta vlerësuar nëse jemi ose jo përpara rastit kur Gjykata e Lartë mund të konkludojë se nga ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit gjyqësor do të vinin pasoja të rënda financiare për palën kërkuese Autoriteti Rrugor Shqiptar.

22- Kolegji Administrativ vlerëson të evidentojë se, duke mbajtur parasysh edhe natyrën e mosmarrëveshjes mes palëve, pozitën e palës kreditore dhe asaj debitore, si edhe natyrën dhe vlerën e detyrimeve që kërkohet të ekzekutohen në çështjen konkrete në shqyrtim, në interpretim dhe zbatim të drejtë të ligjit procedural, mbetet thjesht një kërkim dhe pretendim hipotetik dhe, si i tillë, i pambështetur në ligj, vetëm parashtrimi formal i pretendimit (shkakut) se ekzekutimi mund të sjellë pasoja të rënda financiare, si një shkak që e përcakton vetë neni 479 pika 1 shkronja “a” e Kodit të Procedurës Civile, pa parashtruar njëkohësisht edhe argumenta dhe shpjegime konkrete lidhur me rrethanat që tregojnë mundësinë e ardhjes së tyre.

23- Për sa më sipër, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se nuk ka vend për të pranuar kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese Autoriteti Rrugor Shqiptar, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.602 (86-2019-667), datë 01.03.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, i cili ka ndryshuar vendimin nr.8704, datë 24.07.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

## **PËR KËTO ARSYE**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 1 pika 2 e ligjit nr.49/2012 *“Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”* dhe nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile

## **V E N D O S I**

Mospranimin e kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.602 (86-2019-667), datë 01.03.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, i cili ka ndryshuar vendimin nr.8704, datë 24.07.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të paraqitur nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

**Tiranë, më datë 08.06.2020**

**ANËTAR**  
**Ilir PANDA**

**ANËTAR**  
**Ervin PUPE**

**KRYESUES**  
**Sokol SADUSHI**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E LARTË  
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

**Nr.82/401 i Vendimit.**

**V E N D I M**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

**Sokol SADUSHI - Kryesues**  
**Ervin PUPE - Anëtar**  
**Ilir PANDA - Anëtar**

Në datën 08.06.2020, mori në shqyrtim në dhomën e këshillimit çështjen administrative, që u përket palëve:

**KËRKUES:** Ministria e Financave dhe Ekonomisë

**OBJEKTI:** Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr.1695, datë 30.05.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

**BAZA LIGJORE:** Neni 479 të Kodit të Procedurës Civile

**Në çështjen me :**

**PADITËS:** Artan Rama

**PADITUR:** Ministria e Financave dhe Ekonomisë

**KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË**

Pasi dëgjoji relacionin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe diskutoi çështjen në tërësi në dhomën e këshillimit,

**VËREN**

**I- RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1- Nga aktet e administruara në praktikën gjyqësore, rezulton se pala paditëse Artan Rama, i është drejtuar palës së paditur për të marrë informacion dhe dokumentacionin e

nevojshëm që ka shoqëruar dhënien me qera/përdorim të një pasurie publike, në lidhje me objektet “*Bunk’ Art 1*” dhe “*Bunk’ Art 2*”.

2- Nga ana e palës së paditur me shkresën nr.9673/1 prot., datë 26.12.2016, e datës 20.01.2017, ka vendosur në dispozicion një pjesë të dokumentacionit të kërkuar dhe ka refuzuar për pjesën tjetër me arsyetimin “... *se jo i gjithë dokumentacioni është publik...*”.

3- Për sa më sipër, paditësi duke pretenduar se pala e paditur ka vepruar në kundërshtim me ligjin, i është drejtuar gjykatës me padinë objekt gjykimi.

4- **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë**, me vendimin nr.2846 (80-2017-2879), datë 28.06.2017 ka vendosur:

Pranimin e padisë.

Detyrimin e palës së paditur të kryejë veprimin administrativ për dhënien ndaj paditësit të informacionit dhe dokumentacionit të kërkuar në lidhje me dhënien me qera/përdorim të objekteve shtetërore dhe në rast të mungesës së këtij dokumentacioni të informojë palën paditëse përmes një përgjigjeje zyrtare në lidhje me çdo dokument të kërkuar si më poshtë vijon:

1.Në lidhje me kërkesën për objektin “Ish Vendkomanda e SHPFA“ BUNK‘ART 1:

- Propozimi i pakërkuar ( kërkesa për marrjen me qera).
- Vendimin e Entit përgjegjës të institucionit për kalimin e objektit në përdorim apo çfarëdo forme të përcaktuar, dokumentacioni që tregon vlerën kontabël të objektit.
- Të dhënat fizike të objektit të dhënë me qera.
- Përbërjen e Komisionit të Shqyrtimit të ofertave.
- Dokumentacionin e paraqitur nga konkurentët që kanë marrë pjesë në konkurim.
- Procesverbalin e zhvillimit të konkursit.
- Kontratën e plotë të nënshkruar me subjektin fitues.

2.Në lidhje me kërkesën për objektin Shtylla “ BUNK‘ART 2:

- Propozimi i pakërkuar ( kërkesa për marrjen me qera).
- Vendimin e Entit përgjegjës të institucionit për kalimin e objektit në përdorim apo çfarëdo forme të përcaktuar, dokumentacioni që tregon vlerën kontabël të objektit.
- Të dhënat fizike të objektit të dhënë me qera.
- Përbërjen e Komisionit të Shqyrtimit të ofertave.
- Dokumentacionin e paraqitur nga konkurentët që kanë marrë pjesë në konkurim.
- Procesverbalin e zhvillimit të konkursit.
- Aktet e verifikimi të kryera nga njësitë e monitorimit sipas kriterëve ligjore.

5- **Gjykata Administrative e Apelit Tiranë**, me vendimin nr.1695, datë 30.05.2019 ka vendosur:

Lënien në fuqi të vendimit nr.2846, datë 28.06.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

6- Më datë **19.08.2019** Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në thelb parashtron sa vijon:

- *Vendimet në fjalë janë marrë në interpretim të gabuar të kuadrit ligjor, pasi pala paditëse nuk ka legjitimitet pasiv në këtë proces gjykimi.*

- *Kërkojmë rrëzimin e padisë, pasi informacioni dhe dokumentacioni i kërkuar nga pala paditëse përfshinë të gjithë dokumentat kofidencial të paraqitur nga konkurentët që kanë marrë pjesë në konkurim.*
- *Buxheti i çdo institucioni hartohet dhe miratohet sipas ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në R.SH” dhe ligji nr.99/2018 datë 03.12.2018 “Për buxhetin e vitit 2019”, prandaj duke qenë se përgatitet dhe miratohen si rregull një vit para, nuk mund të parashikohet dhe të paragjykoen vendimet e gjykatave .*
- *Ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda, për shkak se kjo shumë është relativisht e konsiderueshme për tu ekzekutuar dhe e pa mundur të rikthehet.*

## **II- VLERËSIMI I KOLEGJIT ADMINISTRATIV TË GJYKATËS SË LARTË**

7- Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

8- Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

9- Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

*“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:*

*a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose*

*b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.*

10- Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- *ekziston dyshimi i arsyeshem, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të riparueshem dhe të atëçastshëm për kërkuësin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;*
- *(nuk) cenohet rëndë interesi publik.*

11- Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimit nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

12- Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuëse që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshem që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentat e parashtruara të palës kërkuëse duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

13- Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore pasjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashkuar nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjësisë personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

14- Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në funksion të zgjidhjes së çështjes konkrete, vlerëson se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë e paraqitur nga pala e paditur, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, është e pabazuar në ligj dhe si e tillë nuk duhet të pranohet.

15- Ky Kolegj vëren se, në zbatim të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, bashkëlidhur kërkesës për pezullim të palës kërkuëse Ministria e Financave dhe Ekonomisë, gjendet edhe kopja e rekursit të ushtruar nga kjo palë kundër vendimit gjyqësor që kërkohet të pezullohet ekzekutimit.

16- Gjithashtu, ky Kolegj vëren se palët e tjera pjesëmarrëse në gjykimin e çështjes ku është dhënë vendimi gjyqësor që kërkohet të pezullohet, janë njoftuar rregullisht për kërkesën e paraqitur nga pala kërkuëse Ministria e Financave dhe Ekonomisë, të cilat nuk kanë parashtruar argumente lidhur me bazueshmërinë në ligj të kërkesës për pezullim dhe për qëndrimin e tyre.

17- Nga shqyrtimi i shkaqeve konkrete për të cilat pala kërkuëse Ministria e Financave dhe Ekonomisë kërkon pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, Kolegji Administrativ vlerëson se, kjo Kërkesë, në tërësinë e saj, motivohet me shkaqe që kanë të bëjnë vetëm me drejtësinë, bazueshmërinë në prova dhe në ligj, të vendimeve të dhëna nga gjykata administrative e shkallës së parë dhe ajo e Apelit në zgjidhjen e çështjes, të cilat ky

Kolegj i vlerëson në kohën kur shqyrton në dhomë këshillimi shkaqet e rekursit ndaj vendimit të gjykatës administrative të apelit.

18- Për sa i përket motivit të fundit dhe të vetëm, që formalisht përfshihet në rastin e shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, Kolegji Administrativ vëren se pala kërkuese Ministria e Financave dhe Ekonomisë nuk ka paraqitur asnjë provë dhe nuk ka arsyetuar lidhur me ndonjë rrethanë konkrete për ta vlerësuar nëse jemi ose jo përpara rastit kur Gjykata e Lartë mund të konkludojë se nga ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit gjyqësor do të vinin pasoja të rënda financiare për palën kërkuese Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

19- Kolegji Administrativ vlerëson të evidentojë se, duke mbajtur parasysh edhe natyrën e mosmarrëveshjes mes palëve, pozitën e palës kreditore dhe asaj debitore, si edhe natyrën dhe vlerën e detyrimeve që kërkohet të ekzekutohen në çështjen konkrete në shqyrtim, në interpretim dhe zbatim të drejtë të ligjit procedural, mbetet thjesht një kërkim dhe pretendim hipotetik dhe, si i tillë, i pambështetur në ligj, vetëm parashtrimi formal i pretendimit (shkakut) se ekzekutimi mund të sjellë pasoja të rënda financiare, si një shkak që e përcakton vetë neni 479 pika 1 shkronja “a” e Kodit të Procedurës Civile, pa parashtruar njëkohësisht edhe argumenta dhe shpjegime konkrete lidhur me rrethanat që tregojnë mundësinë e ardhjes së tyre.

20- Për sa më sipër, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se nuk ka vend për të pranuar kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese Ministria e Financave dhe Ekonomisë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.1695, datë 30.05.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

### **PËR KËTO ARSYE**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 1 pika 2 e ligjit nr.49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative” dhe nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile

### **V E N D O S I**

Mospranimin e kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.1695, datë 30.05.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, të paraqitur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

**Tiranë, më datë 08.06.2020**

**ANËTAR**  
**Ilir PANDA**

**ANËTAR**  
**Ervin PUPE**

**KRYESUES**  
**Sokol SADUSHI**





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E LARTË  
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

**Nr. 55/345 i Vendimit**

**V E N D I M**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

**Sokol SADUSHI - Kryesues**

**Ervin PUPE - Anëtar**

**Ilir PANDA - Anëtar**

Në datën 08.06.2020, mori në shqyrtim në dhomën e këshillimit çështjen administrative, që u përket palëve:

**KËRKUES:** Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit

**OBJEKTI:** Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr.4304, datë 26.11.2018 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

**BAZA LIGJORE:** Neni 479 të Kodit të Procedurës Civile

**Në çështjen me :**

**PADITËS:** Ilir Merkaj

**PADITUR:** Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit

**KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË**

Pasi dëgjoji relacionin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe diskutoi çështjen në tërësi në dhomën e këshillimit,

**VËREN**

**I- RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1- Nga aktet e administruara në praktikën gjyqësore, rezulton se pala paditëse Ilir Merkaj, ka pasur në pronësi një ndërtesë një katëshe të regjistruar në ZVRPP Vlorë me sipërfaqe 115 m2 truall dhe 115 m2 ndërtim.

2- Nga ana e palës së paditur Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit është ushtruar kontroll pranë palës paditëse për të cilin është mbajtur procesverbali i konstatimit të kundravajtjes nr.3 datë 13.03.2014 dhe ku rezulton një “objekt dy katësh, me sipërfaqe ndërtimore 188 m2, konstrukcion B/A, i ndërtuar në Kaninë.... pa leje përkatëse”.

3- Në vijim rezulton se pala e paditur ka nxjerrë aktin administrative, vendim për prishje objekti nr.01, datë 13.03.2014, i cili është ekzekutuar në datë 16.03.2014 me prishjen e objektit.

4- Për sa më sipër, paditësi duke pretenduar se pala e paditur ka vepruar në kundërshtim me ligjin, i është drejtuar gjykatës me padinë, objekt gjykimi.

**5- Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë**, me vendimin nr.830, datë 09.06.2015 ka vendosur:

Pranimin pjesërisht të kërkesë padisë.

Detyrimin e palës së paditur INUK të dëmshpërblejë dëmin e shkaktuar palës paditëse Ilir Merkaj si pasojë e prishjes së ndërtimit në vlerën 3.773.955 (tre milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e pesë) lekë.

Rrëzimin për pjesën tjetër të padisë.

**6- Gjykata Administrative e Apelit Tiranë**, me vendimin nr.4304, datë 26.11.2018 ka vendosur:

Ndryshimin e vendimit nr.830, datë 09.06.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.

Pranimin e pjesshëm të padisë.

Detyrimin e palës së paditur Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit të shpërblejë paditësit Ilir Merkaj dëmin e shkaktuar si pasojë e prishjes së ndërtimit prej 115 m2 lokal shërbimi, të regjistruar në pronësi të tij dhe 188 m2 ndërtim i papërfunduar në proces legalizimi, në vlerën 11.208.186 (njëmbëdhjetë milion e dyqind e tetë mijë e njëqind e tetëdhjetë e gjashtë) lekë.

Rrëzimin për pjesën tjetër të padisë.

7- Më datë **01.07.2019** Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në thelb parashtron sa vijon:

- *Referuar të dhënave të kërkesë padisë në tërësinë e saj, kjo edhe në zbatim të praktikës së Kolegjeve të Gjykatës së Lartë (vendim nr.00-2014-2907 (408), datë 01.07.2014), rezulton se paditësi kërkon shpërblimin e dëmit, pa goditur më parë veprimin administrativ.*
- *Nga përkufizimi i neneve 608 dhe 609 të Kodit Civil, si dhe nga praktika gjyqësore, del se katër janë kushtet që duhen plotësuar për të patur një dëm jashtëkontraktor (a) ekzistenca e dëmit; (b) kundërligjshmëria e veprës; (c) faj; (d) lidhja shkaksore midis veprimit dhe dëmit të shkaktuar, të cilat duhet të përmbushen në mënyrë kumulative, për të patur përgjegjësi, e cila nuk rezulton.*
- *Gjykata shprehet se INUK ka vepruar në tejkalim të kompetencave të parashikuar nga ligji nr.9780 datë 16.07.2007, qëndrim ky i gabuar, pasi në rastin konkret është konstatuar kundërvajtje në fushën e ndërtimit, pasi kemi një ndërtim pa leje.*
- *Akti i ekspertimit është i paplotë, pasi ekspertja i referohet vlerës aktuale të tregut dhe nuk i referohet vlerës së ndërtimit.*

- *Ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda dhe të pariparueshme, pasi vazhdimi i ekzekutimit do të çonte në bllokimin e zërit 602 të buxhetit të institucionit.*

## **II- VLERËSIMI I KOLEGJIT ADMINISTRATIV TË GJYKATËS SË LARTË**

8- Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast, këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

9- Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm, nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

10- Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në procesin e tij vendimmarrës ka përcaktuar dhe kriteret që duhet të mbahen parasysh kur kërkohet dhe vendoset mbrojtja e përkohshme procedurale. Marrja e një mase të përkohshme është një përjashtim që rezervohet për ato çështje, kur arsyet për zbatimin e saj janë aq të forta, saqë e bëjnë ndërhyrjen e gjykatës të paevitueshme. E thënë ndryshe, për ato raste kur një kërkesë për një vendim të ndërmjetëm është e justifikuar nga arsye veçanërisht të rëndësishme.

11- Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

*“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:*

*a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose*

*b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.*

12- Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- *ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të riparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;*
- *(nuk) cenohet rëndë interesi publik.*

13- Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

14- Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentat e parashtruara të palës kërkuese duhet të jenë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

15- Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashkuar nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjësisë personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

16- Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në funksion të zgjidhjes së çështjes konkrete, vlerëson se, në rastin në shqyrtim, kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë e paraqitur nga pala e paditur, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, është e bazuar në ligj dhe si e tillë duhet të pranohet.

17- Ky Kolegj vëren se, në zbatim të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, bashkëlidhur kërkesës për pezullim të palës kërkuese Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, gjendet edhe kopja e rekursit të ushtruar nga kjo palë kundër vendimit gjyqësor që kërkohet të pezullohet ekzekutimit.

18- Gjithashtu, rezulton se palët e tjera pjesëmarrëse në gjykimin e çështjes ku është dhënë vendimi gjyqësor që kërkohet të pezullohet, janë njoftuar rregullisht për kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, i cili ka parashtruar dhe argumentuar lidhur me mosbazueshmërinë në ligj të kërkesës për pezullim dhe në thelb të qëndrimit të tij kërkon mospranimin e kërkesës si të pabazuar në ligj.

19- Nga shqyrtimi i shkaqeve konkrete për të cilat pala kërkuese Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit kërkon pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, Kolegji Administrativ vlerëson se, kërkesa, fillimisht orientohet te pretendimet ligjore që kanë të bëjnë me dyshimin e fortë për drejtësinë, bazueshmërinë në prova dhe në ligj, të vendimeve të dhëna nga gjykata administrative e shkallës së parë dhe, në veçanti, ajo e Apelit në zgjidhjen e çështjes, pretendime të cilat do të shqyrtohen hollësisht në fazën e vlerësimit nga dhoma e këshillimi të shkaqeve të rekursit.

20- Për sa i përket shkakut kryesor të kërkesës që lidhet me pezullimin e ekzekutimit gjyqësor ( si një masë mbrojtje ligjore paraprake), që referohet në nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile, Kolegji Administrativ vëren se pala kërkuese, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit ka parashtruar dhe dhënë argumente lidhur me rrethanën konkrete, me qëllim që të vlerësohet se është rasti kur Gjykata e Lartë mund të konkludojë se nga ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit gjyqësor do të vinin pasoja të rënda financiare për palën kërkuese.

21- Kolegji Administrativ çmon të nevojshme të theksojë se, duke mbajtur parasysh edhe natyrën e mosmarrëveshjes mes palëve, pozitën e palës kreditore dhe asaj debitore, si edhe natyrën dhe vlerën e detyrimeve që kërkohet të ekzekutohen në çështjen konkrete, në interpretim dhe zbatim të drejtë të ligjit procedural, mbetet një kërkim dhe pretendim i mbështetur në ligj, si një shkak që e përcakton vetë neni 479 pika 1 shkronja “a” e Kodit të Procedurës Civile,

22. Shkaku i pretenduar nga ana e palës kërkuese, se vlera shumë më e madhe e shpërblimit të akorduar nga ana e Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, që ka ndryshuar vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, do të vinte në vështirësi financiare institucionin dhe do të çonte në bllokimin e aktivitetit për shkak të bllokimi të shpenzimeve të zërit “602”, është një rrethanë thelbësore që bind Kolegjin se ekzekutimi i këtij vendim do të vështirësonte ushtrimin e aktivitetit normal të këtij institucioni publik, për shkak të natyrës së funksioneve që ushtron, duke cënuar interesin publik.

23- Kolegji ka bindjen se marrja e një vendimi pezullimi jepet në atë rast kur, pa dhënien e një vendimi të tillë, ekziston një rrezik i drejtpërdrejtë, i atëçastshëm, që procesi i çështjes thelbësore, do të bëhet i pakuptimtë. Në rastin konkret, Kolegji vlerëson se marrja e një mase të përkohshme që është një procedurë autonome, mund të rregullojë këtë situatë që paraqitet urgjente dhe që parandalon dëme të rënda dhe thelbësore në funksion të së mirës publike.

24- Për sa më sipër, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se ka vend për të pranuar kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.4304, datë 26.11.2018 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

## **PËR KËTO ARSYE**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 1 pika 2 e ligjit nr.49/2012 “*Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative*” dhe nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile;

## **V E N D O S I**

Pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.4304, datë 26.11.2018 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, të paraqitur nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, deri në shqyrtimin e çështjes përfundimisht nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë.

**Tiranë, më datë 08.06.2020**

**ANËTAR**  
**Ilir PANDA**

**ANËTAR**  
**Ervin PUPE**

**KRYESUES**  
**Sokol SADUSHI**

